

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE MIREQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

KONTRATA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIREQENIES SOCIALE, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

„Epoka e Re” Adresa: Sheshi Edit Durhan nr 45, Prishtinë (në vazhdim “Operatori Ekonomik”), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Shërbimet e Publikimeve në shtypin ditorë për nevoja të MPMS-së, Ri-shpallje me numër Identifikues 209-19-4941-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Shërbimet e Publikimeve në shtypin ditorë për nevoja të MPMS-së, Ri-shpallje**

NR.RENDOR	Përshkrimi	Formati i publikimit	Sasia per 24 muaj
1	Publikimi në brendi të gazetës bardh e zi	1/1- faqja e plotë	47
2	Publikimi në brendi të gazetës bardh e zi	1/2 e faqes	27
3.	Publikimi në brendi të Gazetës bardh e zi	1/4 e faqes	9
4	Publikimi në brendi të gazetës bardh e zi	1/8 e faqes	9

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 08.08.2019 dhe përfundon me 08.08.2021.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se ne ditën e marrjes së urdhëreses për publikim.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë gazeta e operatorit ekonomik

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Në këtë rast, nuk vlenë pragu apo tavani prej +/- 30%, bazuar në nenin 56.15 Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik dt. 10.04.2019, kurse vlera e parashikuar e kontratës është 5,000.00 €.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Kontrata përbëhet nga me shume se një dërgesë shëno

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *shërbimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *shërbimeve*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të *realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *shërbimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë

Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykata ekonomike e Prishtinës* në pajtim me ligjin e Kosovës. në pajtim me ligjin e Kosovës.





Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqip*² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	SADIK ZEQIRI	Emri:	Feti Ibishi
Pozita:	DREKTOR	Pozita:	Udhëheqës i zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.08.2019	Data:	08.08.2019
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Shërbimet e Publikimeve në shtypin ditorë për nevoja të MPMS-së, Ri-shpallje. Nr. Brendshem i Prokurimit:MPMS-209-19-017-236

F pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Nr.	Përshkrimi	Formati i publikimit	Sasia e publikimeve për 24 muaj	Çmimi per njësi me TVSH	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1	Publikimi në brendi të gazetës bardh e zi	1/1- faqes	47	30.00	1,410.00
2	Publikimi në brendi të gazetës bardh e zi	1/2 e faqes	27	50.00	1,350.00
3	Publikimi në brendi të gazetës bardh e zi	1/4 e faqes	9	30.00	270.00
4	Publikimi në brendi të gazetës bardh e zi	1/8 e faqes	9	1.00	9.00
Totali i përgjithshëm me TVSH					5,039.00

REKAPITULLIMI

Nr.	Përshkrimi	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €	Pesha e Çmimit sipas rëndësisë	Çmimi per njësi me TVSH pas peshimit në €
1	Publikimi në brendi të gazetës bardh e zi, (1/1 e faqes komplet)	1,410.00	60%	846.00
2	Publikimi në brendi të gazetës bardh e zi, (1/2 e faqes)	1,350.00	20%	270.00
3	Publikimi në brendi të gazetës bardh e zi, (1/4 e faqes)	270.00	10%	27.00
4	Publikimi në brendi të gazetës bardh e zi, (1/8 e faqes)	9.00	10%	0.90
TOTALI I ÇMIMIT TË PESHUAR			100%	1,143.90

Identifikimi i operatorit ekonomik (OE)

Emri i OE:	Epoka e re
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të OE:	Sedik Zeqiri
Nenshkrimi:	
Data:	29.07.2019
Vula:	



Vendosja: Ju lutemi kontrolloni formulet para plotësimit të çmimeve